



Buletini

- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
- * Aktivitetet nga Programi për Stafin administrative të gjykatave dhe prokurorive
- * Aktivitetet tjera

Korrik –Gusht 2018

Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike sipas LPK-së

Më 03 korrik 2018, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm, organizoj trajnimin me temë: “Mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike sipas LPK-së”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan: ankesa, revizioni dhe propozimi për përsëritje të procedurës. Ndërsa në pjesën e dytë u trajtua raporti në mes revizionit dhe propozimit për përsëritjen e procedurës dhe kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Në vazhdim të trajnimit u potencua se me rastin e vendimmarrjes nga ana e gjykatave të instancës më të ulët, jo rrallë ndodhë që të bëhen gabime në aspektin formal dhe material, të cilat mund të kenë ndikim në garantimin e ligjshëm të të drejtave të palëve në procedurën kontestimore. Andaj e drejta e goditjes së vendimeve është një e drejtë elementare e cila garantohet edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës por edhe me Ligjin për Procedurën Kontestimore. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 32 të saj garanton të drejtën për mjetin juridik duke përcaktuar se: “Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative

të cilat cenojnë të drejtë ose interesat e tij në mënyrën e përcaktuar me ligj”.

Gjithashtu në këtë trajnim u potencua se sa i përket gjerësisë së rishikimit që duhet të bëhet nga gjykata më e lartë, është standard themelor që rishikimi gjyqësor nga një gjykatë më e lartë të përfshijë si kontrollin e të drejtave procedurale ashtu edhe kontrollin e meritës së rastit, duke mundësuar që një gjykatë më e lartë të bëjë rishikimin si formal ashtu edhe substancial të rastit të gjykuar në shkallë të parë. Në vazhdim u veçua mendimi se qëllimi kryesor i të gjitha mjeteve të jashtëzakonshme juridike, është sigurimi i realizimit të ligjshmërisë së proceseve gjyqësore nga të cilat rezultojnë vendime të cilat paraqesin zgjidhje të ligjshme dhe të drejta të çështjeve konkrete dhe ashtu përmes mjeteve të jashtëzakonshme juridike, sigurohet në shkallë të fundit gjyqësore edhe kontrollimi i ligjshmërisë së këtyre vendimeve me të cilat vendoset për të drejtat subjektive dhe interesat e palëve në kontest civil, në njërën anë, dhe në anën tjetër me nxjerrjen e vendimeve sipas këtyre mjeteve të jashtëzakonshme juridike ndikohet në unifikimin e praktikës gjyqësore në gjykatat e shkallës më të ultë, dhe në sigurimin e zbatimit të ligjit.

Gjatë trajnimit pjesëmarrësit patën mundësi që përmes materialit të ofruar nga trajnuesit, diskutimeve, analizës së rasteve studimore, t'i zbërthejnë drejtë dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore. Gjithashtu u përdoren edhe metoda e shpjegimit të pjesshëm teorik dhe raste nga praktika gjyqësore dhe mënyra të vendosjes meritorie në raste konkrete.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët të nivelit themelor nga departamentet e përgjithshme- divizionet civile.

Trafikimi me qenie njerëzore

Më 05 dhe 06 korrik 2018, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm, ka realizuar trajnimin me temë “Trafikimi me qenie njerëzore”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte ngritja e kapaciteteve profesionale të pjesëmarrësve lidhure me efikasitetin dhe kompetencën në luftën kundër kryesve të veprave penale të trafikimit me njerëz.

Gjatë trajnimit u trajtua korniza ligjore vendore dhe ajo ndërkombëtare që rregullon këtë fushë,

veprat penale të trafikimit me qenie njerëzore si dhe identifikimi i elementeve të këtyre veprave penale. Gjatë diskutimeve gjithashtu u shtjelluan dallimet dhe ngjashmëritë në mes të trafikimit me njerëz dhe kontrabandimit me migrantë si dhe mënyrat për parandalimin e këtyre veprave të cilat janë vazhdimisht në rritje.

Trajnimi u zhvillua në mënyrë interaktive, ku u diskutuan sfidat dhe problemet të cilat pjesëmarrësit i hasin në praktikën gjyqësore. Në pjesën e fundit të trajnimit, pjesëmarrësit u ndanë në grupe punuese ku punuan në raste praktike të parashtruara nga trajnuesi.

Përfitues të këtij trajnimi ishin prokurorë dhe gjyqtarë të nivelit të apelit dhe nivelit themelor.



Kontrata nga Prokurimi Publik

Më 10-11 korrik 2018, Akademia e Drejtësisë e përkrahur nga GIZ, “Projekti për Reformë Ligjore dhe Administrative” organizoj trajnimin me temë: “Kontrata nga Prokurimi Publik”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me kontratën dhe procedurën e prokurimit publik, standardet ndërkombëtare, evropiane dhe praktikën e mira në këtë lëmi.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan temat si: rëndësia e prokurimit publik, procedura e tenderimit dhe lidhja e kontratës. Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan temat lidhur me të drejtat e detyrimit e palëve pas lidhjes së kontratës, administrimi i kontratës dhe përzgjedhja e organit mbikëqyrës, pranimi i punëve dhe kompensimi, problematikat që paraqiten gjatë fazës së implementimit të kontratës, trajtimi i punëve që tejkalojnë kontratën dhe kompensimi i tyre, punët shtesë, punët e domosdoshme dhe ndryshimet e tyre.

Në vazhdim të trajnimit u potencua se procesi i prokurimit publik në Republikën e Kosovës është i rregulluar tani me Ligjin për Prokurimin Publik në fuqi i cili ka për qëllim të sigurojë mënyrën efikase, transparente dhe të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve e burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Republikën e Kosovës duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe burimet e tilla.

Gjithashtu në këtë trajnim u konkludua se sa i përket konfliktit administrativ, ai mund të zhvillohet vetëm kundër aktit administrativ, prandaj objekt i konfliktit administrativ është çështja e ligjshmërisë së aktit administrativ i cili atakohet me padi. Në rastin konkret objekt i konfliktit administrativ është vendimi i OSHP-së, që do të thotë se konflikti administrativ mund të fillohet kundër aktit administrativ të nxjerrë nga OSHP-ja, si vendim përfundimtar administrativ.

Në vazhdim u veçua mendimi se sipas dispozitave të Ligjit për Konflike Administrative, ligjshmëria e aktit administrativ të kontestuar shqyrtohet nga gjykata brenda kufijve të kërkesës nga padia, por nuk obligohet nga shkaqet e padisë. Gjersa për nulitetin e aktit administrativ gjykata përkujdeset sipas detyrës zyrtare. Për shkak të rëndësisë së pasojave të këtyre akteve administrative LKA e detyron gjykatën që sipas detyrës zyrtare të vlerësojë nulitetin e aktit administrativ, pavarësisht se këtë fakt e ka theksuar apo jo paditësi.

Gjatë trajnimit pjesëmarrësit patën mundësi që përmes materialit të ofruar nga trajnuesit, diskutimeve, analizës së rasteve, t’i zbërthejnë drejtë dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe t’i adresojnë dilemat dhe vështirësitë që hasen në praktikën gjyqësore aktuale. Gjithashtu u përdoren edhe metoda e shpjegimit të pjesshëm teorik dhe raste nga praktika gjyqësore dhe mënyra e vendosjes së tyre.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe gjyqtarët e Gjykatave Themelore, prokurorët e Prokurorive Themelore dhe të Apelit.

Neni 2 i KEDNJ – e drejta për jetën

Më 13 korrik 2018, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, organizoj trajnimin me temë: “Neni 2 i KEDNJ – e drejta për jetën”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me nenin 2 të KEDNJ – e drejta për jetën, dhe zbatimin e praktikës së GJEDNJ lidhur me këtë nen.

Ky trajnim trajtoj përmbajtjen dhe rëndësinë e mbrojtjes së të drejtës për jetën, historikun dhe efektin e zbatimit të nenit 2 të Konventës - protokollit 6 dhe 13 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kufizimi i dënimit me

vdekje, abrogimi i plotë i dënimit me vdekje, dënimi me vdekje dhe ekstradimi.

Gjatë trajnimit përmes diskutimeve dhe analizës së rasteve praktike janë adresuar çështje të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, se si gjykata i ka zgjedhur rastet e ngjashme për të ofruar zgjidhje meritore për rastet e kësaj natyre.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarë të nivelit themelor nga regjione të ndryshme të Kosovës.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar

Aktivite e realizuara në trajnimin fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar

Në kuadër të trajnimit fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar, gjatë muajit korrik janë realizuar gjithsejtë 8 (tetë) sesione trajnuese nga modulet: “E drejta civile, ekonomike dhe administrative”, “Shkathësitë personale dhe ndër personale” dhe “Rendi juridik kombëtarë dhe ndërkombëtarë”.

Nga nën moduli “Arsyetimi i vendimeve gjyqësore” janë realizuar katër (4) sesione trajnuese në të cilat janë trajtuar: shkrimi ligjor dhe metodologjia e përdorimit të formulës IRAC, arsyetimi i vendimeve gjyqësore në lëmin penale dhe civile dhe parimet e të shkruarit mirë. Objektivat e këtij nën moduli qëndrojnë tek zbatimi në mënyrë efikase të shkruarit ligjor sipas metodës IRAC, hartimi i vendimeve sipas metodës IRAC, zbatimi i parimeve dhe hapave nëpër të cilat kalon procesi i të shkruarit mirë.

Në kuadër të nën moduli “E drejta pronësisë dhe të drejtat tjera sendore janë realizuar tri (3) sesione trajnuese ku gjyqtarët e sapo emëruar

kanë zhvilluar kompetencën profesionale mbi këto çështje: Të drejtat sendore në sendet e huaja, vërtetimi, konstituimi dhe ndërprerja e servituteve sendore, dhe mbrojtja e servituteve sendore, humbja e të drejtës së pronësisë dhe e drejta e ndërtimit (Superficies). Ndërsa në nga nën moduli “Organizmi i sistemi gjyqësor dhe prokurorial” është realizuar një (1) sesion trajnimi, ku është përqendruar tek struktura dhe organizimi i gjyqësorit, procedurat gjyqësore në përputhje me kompetencat e gjykatave si dhe dallimi i kompetencave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga kompetencat e gjykatave dhe organeve tjera që kryejnë funksione nga fusha e drejtësisë.

Ndërsa komponenta e trajnimit praktikë, për këtë periudhë është realizuar përmes vijimit të praktikës nga ana e gjyqtarëve të sapoemëruar në gjykata përkatëse, konform orarit të përcaktuar me program. Trajnimin fillestar për gjyqtarët e sapoemëruar janë duke e ndjekur 54 gjyqtarë të sapo emëruar, ku 5 prej tyre janë nga komuniteti serb.



Aktivitet e realizuar në kuadër të trajnimit fillestar për prokurorët e sapo emëruar

Akademia e Drejtësisë, gjatë muajit korrik në kuadër të trajnimit fillestar për prokurorët e sapo emëruar, ka vazhduar me realizimin e aktiviteteve të planifikuara sipas programit trajnues. Në këtë periudhë janë realizuar gjashtë (6) sesione trajnuese nga moduli “Kodi i Procedurës Penale”.

Nga nën moduli “Masat e fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit” janë realizuar tri (3) sesione trajnuese në të cilat janë trajtuar: shfrytëzimi i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes, blerje e simuluar e ndonjë sendi, dhe simulim i veprës së korrupsionit, kontrolli dërgesave postare dhe dërgim i kontrolluar i dërgesave postare si dhe vëzhgimi i fshehtë fotografik ose me video dhe monitorim i fshehtë i bisedave. Prokurorët e sapo emëruar kanë pasur rastin të avancojnë njohuritë e tyre lidhur me zbatimin e këtyre masave të fshehta, hartimin e kërkesave për autorizimin e këtyre masave si dhe identifikimin e kohëzgjatjes së

këtyre masave.

Gjithashtu në kuadër të nën modulit “Procesverbalet” janë realizuar tri (3) sesione trajnuese, ku pjesëmarrësit kanë trajtuar: hartimin dhe mbajtjen e procesverbaleve, regjistrimin e seancave me incizim audio dhe me incizim audio dhe video, shikimin e procesverbalit dhe shkresave të lëndës. Fokusi është përqendruar tek rëndësia e procesverbalit në praktikë si dhe përpilimi i tij.

Ndërsa komponenta e trajnimit praktikë, për këtë periudhë është realizuar përmes vijimit të praktikës nga ana e prokurorëve të sapoemëruar në prokurori përkatëse, konform orarit të përcaktuar me program.

Trajnimi fillestar janë duke e ndjekur 22 prokuror të sapoemëruar, 3 prej tyre janë të komunitetit serb.



Aktivitetet për stafin administrative gjyqësor dhe prokurorial

Komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun

Më 12-13 korrik 2018, Akademia e Drejtësisë me mbështetjen e GIZ, realizoi trajnimin për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial me temën “Komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve për qasje më të mirë në komunikim, raportim me media si dhe marrëdhëniet me publikun.

Gjatë këtij sesiioni trajnues u trajtua: Qasja e publikut në procedurat gjyqësore, qasja e mediave në procedurat gjyqësore, raportimi në procedurat gjyqësore, prezantimi institucional dhe informata me publikun.

Me theks të veçantë u trajtua rëndësia e prezantimit publik, kuptimi i kontekstit, kuptimi i kërkesës/ interesimit, kuptimi i

informatës apo mesazhit. Gjatë këtij sesiioni trajnues u diskutua për organizimin e konferencës për shtyp, procesi i përgatitjes së prezantimit, rezultatet e prezantimit, prezantimi para publikut dhe prezantimi në media.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, ku pjesëmarrësit kishin mundësi të paraqesin sfidat dhe vështirësitë që ballafaqohen në punën e tyre të përditshme në lidhje me media dhe publikun.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: administratorë, bashkëpunëtorë profesional, zyrtarë ligjor, zyrtarët për informim nga gjykata dhe prokurori të niveleve të ndryshme.



Menaxhimi i rasteve në Prokurorinë e Shtetit

Më 30-31 korrik 2018, Akademia e Drejtësisë, me mbështetjen e GIZ, ka realizuar trajnimin me temën “Menaxhimi i dosjes në Prokurorinë e Shtetit”.



Qëllimi i trajnimit është avancimi i njohurive të pjesëmarrësve rreth procesit të menaxhimit të rasteve.

Trajnimi ka filluar duke përmbledhur pikat e temës që do të trajtohen brenda dy ditëve, përfshirë kuptimin dhe rëndësinë e menaxhimit të rrjedhës së rasteve, funksionet apo parimet e

menaxhimit, regjistrat në prokurorinë e shtetit, rolin e zyrës për menaxhimin e lëndëve në mbajtjen e regjistrave, organizimin e rrjedhës së punës dhe zhvillimit të lëndës, procedimin dhe menaxhimin e lëndëve, afatet ligjore për rastet e caktuara, etj.

Gjithashtu gjatë trajnimit është diskutuar rreth problematikave me të cilat ballafaqohet stafi administrativ gjatë punës në prokurori, dhe rëndësia e menaxhimit në rregullimin e raporteve kolegjiale për të rritur efikasitetin në punë.

Gjatë ditës së dytë është trajtuar mbledhja e të dhënave statistikore dhe raportimi, menaxhimi efikas i lëndës bazuar në metodologjinë e CEPEJ, parimet e kësaj metodologjie, kontrolli i lëvizjes së lëndëve si dhe arkivimi i tyre.

Trajnimi është zhvilluar në mënyrë interaktive me bashkëbisedim mes trajnuesve dhe pjesëmarrësve.

Përfitues të këtij trajnimi janë stafi administrativ prokurorial, zyrtarë ligjor dhe zyrtarë financiar.



Aktivitetet tjera

Trajnimi i mbështetur nga EJTN, “E drejta e BE-së për ambientin”

Më 09-10 korrik 2018, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Rrjetin Evropian të Trajnimit Gjyqësor (EJTN), organizuan një program trajnimi për gjyqtarë me temë “E drejta



e BE-së për ambientin” i cili u mbajt në Trier të Gjermanisë.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve rreth zbatimit të direktivave të Bashkimit Evropian në vendimet

e Gjykatave vendore të shteteve anëtare të BE-së.

Gjatë dy ditëve, trajnimi është zhvilluar përmes shpjegimit teorik dhe rasteve të studimit, të ndarë në tri grupe duke diskutuar në grup dhe pastaj është kërkuar të jepet përgjigje e saktë lidhur me rastin para trajnuesve.

Trajnimi u vlerësua lartë, duke pasur mundësi që për se afërmi të shihen se si zbatohen direktivat e Bashkimit Evropian, praktikat e Gjykatave të shteteve anëtarë të BE-së, si dhe vendimet e gjykatave Evropiane.

Në këtë trajnim kanë marrë pjesë gjyqtarë të shteteve anëtare të BE-së, dhe vendeve tjera përfshirë Ballkanin Perëndimor.



Punëtori për zhvillimin e kurseve trajnuese për platformën e mësimit në distancë

Me 11 korrik 2018, Akademia e Drejtësisë, realizoi punëtorinë me trajnues për zhvillimin e kurseve trajnuese për platformën e mësimit në distancë / E-learning.

Qëllimi i punëtorisë ishte avancimi i njohurive të trajnuesve rreth platformës së mësimit në distancë, mënyrën e funksionimit të saj si dhe zhvillimin e kurseve trajnuese sipas shablloleve të platformës.

Fillimisht në këtë punëtori është prezantuar platforma e mësimit në distancë me ç ‘rast përfituesit janë familjarizuar me kurset trajnuese dhe me mënyrën e ndjekjes së kurseve në platformës. Gjatë punëtorisë janë krijuar llogari për pjesëmarrësit për tu qasur në platformë, si

dhe janë njoftuar me shembujt për përshtatjen e materialeve që kërkon platforma e mësimit në distancë.

Paraprakisht nga trajnuesit është kërkuar që të përgatisin materialet në formatin Word, ndërsa gjatë punëtorisë, pjesëmarrësit të ndarë në grupe varësisht nga moduli rishikuan, zhvilluan, përshtaten dhe prezantuan kapitujt e materialit trajnues në pajtim me shabllonet dhe strukturën që kërkon platforma e mësimit në distancë.

Pjesëmarrës në punëtori ishin gjyqtarë dhe prokurorë, trajnues të Akademisë së Drejtësisë, autorë të hartimit të kurseve trajnues.



Vizitë studimore “Trajtimi i përshtatshëm për fëmijë dhe bashkëpunimi ndërmjet zyrave të prokurorive, gjykatave, shërbimit të sprovës dhe institucioneve të tjera për të mitur”

Më 16-20 korrik 2018, në kuadër të projektit IRZ dhe UNHCR, në Gottingen/Hameln të Gjermanisë është realizuar një vizitë studimore e një delegacioni kosovar me temë “Trajtimi i përshtatshëm për fëmijë dhe bashkëpunimi ndërmjet zyrave të prokurorive, gjykatave, shërbimit të sprovës dhe institucioneve të tjera për të mitur në sferën juridiksionit për të mitur”.

Qëllimi i punëtorisë ishte njoftimi i pjesëmarrjeve për të drejtat e fëmijëve në procedimin penal. Dita e parë e vizitës iu dedikua institucionit të burgut të hapur për të mitur në Gottingen, ku pjesëmarrësit patën rastin të njoftohen në mënyrë të hollësishme për drejtat e fëmijëve dhe trajtimin e tyre në këtë institucion.

Delegacioni vizitoi Gjykatën e shkallës së parë në Gottingen, ku morën pjesë në një seancë gjyqësore për të mitur për tu njoftuar më hollësisht si zhvillohet seanca në mënyrë të përshtatshme për fëmijët, cili është roli i gjyqtarit dhe prokurorit në procedimin penal për të mitur, si bëhet orientimi edukativ i procedimit penal për të mitur dhe dënimet alternative, cilat janë detyrat e shërbimit të

provës në procedimin penal për të mitur si dhe ofertat sociale – pedagogjike ambulante për të mitur në konflikt me ligjin si sanksione edukative alternative.

Gjatë kësaj vizite u vizitua edhe Burgu për të mitur në Hameln. Çështjet që u trajtuan gjatë kësaj vizite u përqendruan në orientimin edukativ të ekzekutimit penal për të mitur, regjimi i mbyllur dhe i hapur, edukimi dhe trajnimi në burgun për të mitur, masat e posaçme të trajtimit si dhe përgatitja e lirit. Ditëve në vijim u vazhdua me vizitë në Prokurorinë për të Mitur dhe institucionin e ndalimit për të mitur, për tu njoftuar se cilat janë grupet e ndalimit të të miturve, për konceptin e ekzekutimit afatshkurtër dhe edukativ të ndalimit të të miturve, ndalimin e të miturve për zbatimin e masave alternative edukative si dhe bashkëpunimi me partnerë të jashtëm.

Në këtë vizitë morën pjesë: gjyqtarë, prokurorë, avokatë, përfaqësues nga UNICEF-i, zyrtar nga Shërbimi Sprovues dhe nga Akademia e Drejtësisë.



Konferencë përmbyllëse e Projektit të Binjakëzimit “Mbështetje e mëtejme e reformës për arsimim ligjor”

Më dt. 23 korrik 2018, Akademia e Drejtësisë dhe Projekti i Binjakëzimit “Mbështetje e mëtejme e reformës për arsimim ligjor” kanë realizuar Konferencën Përmbyllëse të këtij projekti. Projekti i Binjakëzimit “Mbështetje e mëtejme e reformës për arsimim ligjor” ishte i financuar nga Bashkimi Evropian i zbatuar nga kosnsorciumi gjermano holandez, përfaqësuar nga Fondacioni Gjerman për Bashkëpunim



Ligjor Ndërkombëtar (IRZ) dhe Qendra Holandeze për Ndihmë Ligjore Ndërkombëtare (CILC), ku përfitues i këtij projekti ishte Akademia e Drejtësisë.

Qëllimi kryesor i këtij projekti ishte fuqizimi i sundimit të ligjit në Kosovë përmes përmirësimit të trajnimit dhe arsimimit profesional ligjor, veçanërisht duke mbështetur procesin e transformimit të Akademisë së Drejtësisë dhe duke ngritur kapacitetet e saj për trajnim.

Në këtë konferencë përmbyllëse ishin të pranishëm Kryeprokurori i Shtetit z. Aleksandër Lumezi cili njëkohësisht është edhe Kryesues i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, z. Enver Peci Kryetar i Gjykatës Supreme, përfaqësuesit e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, të IRZ-it dhe CILC-it, dhe organizatave

të tjera ndërkombëtare dhe vendore, gjyqtarë dhe prokurorë.

Z. Aleksander Lumezi, ka theksuar me këtë rast se Akademia e Drejtësisë, në pajtim me mandatin ligjor që ka, gjithnjë ka bërë përpjekje në avancimin e programeve trajnuese dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve profesionale ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve. Kjo gjë, pa dyshim është mbështetur fuqishëm nga ky projekt. Në fjalimin e tij z. Lumezi ka nënvizuar faktin se Akademia e Drejtësisë, në vitin 1017 ka përmbyllur procesin e transformimit nga Instituti Gjyqësor i Kosovës. “Gjatë kësaj kohe ka pasur mjaft takime, diskutime, konsultime, analiza krahasuese në mes sistemeve të ndryshme të institucioneve të trajnimit gjyqësor në rajon dhe vendet e BE-së, koncept dokumente, dhe përfundimisht të gjithë janë pajtuar se sistemi aktual, i cili është i përcaktuar edhe me Ligjin për Akademinë e Drejtësisë është ai që më së miri i përshtatet Kosovës dhe është plotësisht funksional edhe në këtë fazë, kur prezantohen rezultatet e këtij projekti, dhe projekteve të tjera të donatorëve, që kanë mbështetur ndër vite zhvillimin e Akademisë së Drejtësisë, në një institucion që lirisht mund të renditet krahas institucioneve të trajnimit gjyqësor në rajon dhe më gjerë.

Znj. Katarina Grbesa, përfaqësuese e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, ka theksuar se në këtë periudhë dy vjeçare Akademia ka pasur sfida të mëdha, si procesi i transformimit, reforma shtetërore administrative, mirëpo kemi shtyrë idetë tona fal bashkëpunimit shumë të mirë me Akademinë e Drejtësisë, Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës. Ajo njëkohësisht potencoi se gjatë procesit të reformave Akademia e Drejtësisë duhet të trajtohet si institucion i pavarur.



Z. Valon Kurtaj, Drejtor i Akademisë së Drejtësisë, znj. Christine Jacobi, Udhëheqëse e Projektit, përfaqësuese e Fondacionit Gjerman për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar (IRZ) dhe znj. Eva Erren, udhëheqëse e projektit nga Qendra Holandeze për Ndihmë Ligjore Ndërkombëtare (CILC), prezantuan rolin dhe rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve vendore dhe ndërkombëtare me qëllim të arritjes së rezultateve të larta në zbatimin e projekteve të ngjashme si ky, në të njëjtën kohë theksuan rolin e rëndësishëm që ka Akademia e Drejtësisë për ndërtimin e në sistemi gjyqësor të pavarur, të paanshëm dhe profesional.

Këshilltari Rezident i këtij projekti z. Klaus Erdman si dhe ekspert të të anfgazhaur për realizmin e këtij projekti, në fjalimin e tyre kanë përmbledhur rezultatet kryesore të projektit si: elaborimi i Planit Strategjik 2018-2020 për Akademinë, prezantimi i kornizës së kompetencave për gjyqtaret dhe prokurorët, Doracaku për trajnime me raste praktike dhe doracaku mbi Menaxhimin e trajnimit të cilat do kontribuojnë në efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e rezultateve të projektit, si dhe shumë aktivitete tjera.

Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar gjatë muajit gusht

Në kuadër të trajnimit fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar, gjatë muajit gusht janë realizuar gjithsejtë 15 sesione trajnuese nga modulet: “Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar”, “Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese” dhe “Shkathtësitë personale dhe ndër personale”.

Nga nën moduli “Legjislacioni për të drejtat e njeriut” janë realizuar gjashtë (6) sesione, në të cilat janë trajtuar: neni 2, e drejta për jetë, neni 6, e drejta për një proces të rregullt, neni 8, privatësia, përgjimi dhe mbledhja e të dhënave si dhe neni 13, e drejta për ankim efektiv.

Në kuadër të nën moduli “Etikë profesionale” janë realizuar gjashtë (6) sesione trajnuese, ku gjyqtarët e sapo emëruar kanë zhvilluar kompetencën profesionale mbi këto çështje lidhur me: njohjen me rregullat bazë të etikës gjyqësore e prokuroriale ashtu siç parashikohen në kodet e etikës gjyqësore e prokuroriale, zbrëthimin e parimeve dhe rregullat e kodit në situata të ndryshme të jetës reale, analizimin dhe zgjidhjen e problemeve të etikës, identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve etike, zhvillimin e mendimit kritik në lidhje me etikën si dhe zbatimin e drejtë të rregullave etike dhe kodin e

etikës profesionale.

Në këtë periudhë raportuese, grupi i parë i gjyqtarëve të sapo emëruar kanë realizuar tri (3) sesione nga nën moduli “Zhvillimi i Shkathtësive Gjyqësore”, i cili do të vazhdohet edhe me dy grupe tjera. Ky trajnim realizohet në mënyrë praktike i cili ndikon në mënyrë specifike në ngritjen e shkathtësive për fjalën hyrëse, marrjen e drejtpërdrejtë dhe të tërthorët në pyetje, vënien në dyshim, rehabilitimin dhe fjalën përfundimtare.

Gjatë muajit gusht janë realizuar dy trajnime praktike në institucione jo gjyqësore dhe atë në Agjencinë për Verifikim dhe Klasifikim të Pronës dhe Agjencinë Kadastrale të Kosovës.

Gjithashtu janë realizuar nëntë (9) ditë trajnimi praktikë në gjykatat përkatëse, ashtu siç është e paraparë me programin trajnues.

Trajnimin fillestar janë duke e ndjekur 54 gjyqtarë të sapo emëruar, ku pesë prej tyre janë nga komunitet serb.



Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për prokurorët e sapo emëruar gjatë muajit gusht

Akademia e Drejtësisë, në drejtim të përmbushjes së prgramit trajnues, ka vazhduar me realizimin e aktiviteteve të planifikuara në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar, të cilin janë duke e vijuar prokurorët e shtetit të sapoemëruar.

Gjatë muajit gusht, në kuadër të trajnimit teorik për prokurorët e sapo emëruar janë realizuar 12 sesione trajnuese nga moduli “Kodi i Procedurës Penale” dhe moduli “Legjislacioni vendor dhe ndërkombëtar”.

Nga nën moduli “E drejta e Bashkimit Evropian” janë realizuar pesë (5) sesione trajnuese, ku prokurorët kanë pasur mundësi të thellojnë njohuritë e tyre lidhur me proceset integruese (qoftë në aspektin e integriteteve dhe atyre të zgjerimit) si dhe të arrijnë të kuptojnë në mënyrë më të detajuar funksionimin e BE-së, familjarizimi me institucionet e Bashkimit Evropian, rolin dhe përgjegjësinë e tyre, natyrën e kompetencave të BE-së; njohjen në themel të së drejtës së BE-së, njohjen me krijimin e së drejtës së BE-së, raportin e kësaj të drejtë me atë nacionale dhe ndërkombëtare si dhe procedurat e shqyrtimit gjyqësorë.

Gjithashtu në kuadër të nën modulit “Provat në procedurën penale” janë realizuar katër (4) sesione trajnuese, ku pjesëmarrësit kanë trajtuar: sigurimin e provave në veprimet fillestare të

policisë, sigurimi i provave me anë të masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit, provat në fazën e hetimeve, si dhe bastisjet - kontrolli - sekuestrimi i përkohshëm dhe ekspertizat. Po ashtu edhe nga nën moduli “Dëshmitarët dhe të dëmtuarit në procedurën penale” janë realizuar dy (2) sesione trajnuese ku prokurorët e sapo emëruar kanë avancuar njohuritë e tyre lidhur me zbatimin e infrastrukturës ligjore lidhur me dëshmitarët në procedurën penale, dallimin në mes të dëshmitarëve të rëndomtë, dëshmitarëve të privilegjuar, dëshmitarëve që nuk mund të dëshmojnë, dëshmitarëve që janë të liruar nga dëshmia, dëshmitarëve me nevoja të veçanta, dëshmitarët bashkëpunues dhe dëshmitarët e mbrojtur, si dhe zbatimin e drejtë të marrjes në pyetje dhe deklaratës së dëshmitarëve

Për këtë periudhë prokurorët e sapo emëruar kanë realizuar (11) ditë trajnim praktikë në prokuroritë përkatëse ashtu siç është paraparë me programin trajnues. Në kuadër të trajnimeve me institucionet jo gjyqësore kanë realizuar vizitën në Shërbimin Korrektues, respektivisht në Burgun e Sigurisë së Lartë.

Trajnimin fillestar janë duke e ndjekur 22 prokurorë të sapo emëruar, tre prej tyre janë të komunitetit serb.



Raporti i vizitës së gjyqtarëve të sapo emëruar në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës

Më 20 gusht 2018, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar, organizoi vizitë dhe trajnim në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, në të cilën kanë marrë pjesë gjyqtarët e



sapo emëruar (gjenerata VI).

Qëllimi i kësaj vizitë ishte njoftimi më për së afërmi i gjyqtarëve të sapo emëruar me punën, rolin, funksionin, veprimtarinë dhe sfidat me të cilat ballafaqohet ky institucion.

Gjatë kësaj vizite gjyqtarët e sapo emëruar u njohën me historikun, strukturën dhe ligjshmërinë e krijimit të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, e cila është pasardhëse e dy drejtorive të mëparshme: Agjencia për Pronë (AKP) dhe Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Banesore.

Vizita u fokusua me shumë tek: administrimi i pronave të Agjencisë, zgjidhja e konflikteve bujqësore, regjistrimi i konflikteve pronësore dhe notifikimi i pronës. Gjithashtu u diskutuan sfidat që ballafaqohet ka ky institucion në praktik, në veçanti me numrin e madh të lëndëve, si dhe me numrin e madh të pronave të pa regjistruara.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët e sapo emëruar (gjenerata VI) 2017-2018.



Raporti i vizitës së prokurorëve të sapo emëruar në Burgun e Sigurisë së Lartë

Me dt. 22 gusht 2018, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Shërbimin Korrektues të Kosovës, organizoi vizitë në “Burgun e Sigurisë së Lartë” në Gërdovc, në të cilën kanë marrë pjesë prokurorët e sapo emëruar (gjenerata VII).



Qëllimi i kësaj vizite, ishte që prokurorët e sapo emëruar të njoftohen me rolin, punën, funksionimin kushtet e Burgut të Sigurisë së Lartë.

Në kuadër të kësaj vizite, prokurorët u priten nga Drejtori i Burgut i cili prezantoi strukturën e

organizimit dhe funksionimin e tij, kontrollimin dhe menaxhimin e të burgosurve, kushtet e tyre, sistemin e sigurisë, si dhe aktivitetet e ndryshme që i kanë në dispozicion të burgosurit.

Gjithashtu prokurorët patën mundësi të vizitojnë objektin si dhe të njihen edhe me hapësirat ku të burgosurit zhvillojnë aktivitete sportive, sallat e rekreacionit dhe bibliotekës. Po ashtu prokurorët u njoftuan rreth kapacitetit të këtij burgu për mbajtjen e të burgosurve, kategorizimin, mënyrën e realizimit të vizitave si dhe aspekte tjera që lidhen drejtpërdrejt me punën e prokurorëve.

Nga pjesëmarrësit trajnimi u cilësua shumë frytdhënës dhe i nevojshëm për të ardhmen në punën e tyre.

Përfitues të trajnimit ishin prokurorët e sapo emëruar, (hjenerata VII) 2018-2019.



Raporti i vizitës së gjyqtarëve të sapo emëruar në Agjencinë Kadastrale të Kosovës

Më 29 gusht 2018, në kuadër të programit trajnues për gjyqtarët e sapo emëruar, Akademia e Drejtësisë, ka realizuar vizitën e radhës në Agjencinë Kadastrale të Kosovës.

Qëllimi i kësaj vizite qëndron tek njoftimi i gjyqtarëve të sapo emëruar lidhur me punën, veprimtarinë, bazën ligjore të funksionimit si dhe problemet me të cilat ballafaqohet ky institucion.

Gjyqtarët e sapo emëruar patën mundësi të diskutojnë rreth regjistrimit të parcelave, ndërtesave, objekteve afariste; dhënien e lejeve për banim, fotografimin e objekteve të banimit dhe vendosjen e tyre në harta topografike, punët gjeodezike, si dhe matjet shtetërore. Po ashtu u njoftuan edhe me sistemin e ri për marrjen e certifikatës e ashtuquajtur “E-Kiosku”.

Si çdo institucion tjetër edhe Agjencia Kadastrale e Kosovës përballëj edhe me probleme të natyrave të ndryshme, sidomos me numrin e madh të parcelave të paregjistruara, mos respektimi i barazisë gjinore në regjistrimin e pronave, sistemin horizontal të organizimit etj.

Gjyqtarët e sapoemëruar, bashkërisht me zyrtarët nga Agjencisë Kadastrale të Kosovës, diskutuan për çështjet e interesit të përbashkët, me qëllim të bashkëpunimit reciprok në të ardhmen.

Përfitues të trajnimit ishin gjyqtarët e sapo emëruar (gjenerata VI) 2017-2018.



<https://ad.rks-gov.net>

**Adresa “Lagjja e Spitalit”
Rr. Muharrem Fejza p.n
Prishtinë, Republika e Kosovës**

**Tel: + 381 38 200 18 660
Fax: + 381 38 512 095
E-mail: infoad@rks-gov.net**